



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 554, datë 18.6.2015

PËR

SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT  
TË POGRADECIT DHE MIRATIMIN E RREGULLORES  
PËR ADMINISTRIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike të përcaktuara në të, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e rregullores së administrimit të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban përzbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A

MINISTRI I KULTURËS  
MIRELA KUMBARO FURXHI



**RREGULLORE**  
**PËR**  
**ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË POGRADECIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe objektivat**

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit.

Objektivat kryesorë të kësaj rregullore janë:

1. Administrimi i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
2. Mbrotja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit;
3. Mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Pogradecit për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit.

**Neni 2**  
**Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje**

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Pogradecit, për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore, i nënshtrohet ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar me ligjin nr.9882, datë 28.2.2008, dhe vendimit nr.426, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”.
2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje e qytetit të Pogradecit, përbëhet nga:
  - a) Qendra Historike;
  - b) Zona e Mbrojtur.
3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.
4. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Pogradecit duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur.

**Neni 3**  
**Qendra Historike dhe kufijtë e saj**

1. Qendra Historike e Pogradecit është hapësira me vlera të rëndësishme historike dhe urbanistiko-arkitekturore që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit të Pogradecit dhe tiparet urbanistiko-arkitekturore që u formuan gjatë historisë së tij.
2. Qendra historike përbledh brenda kufijve të saj:
  - a) Ansamblin në Lagjen e Burimave (Topleci), i cili ruan rrjetin rrugor karakteristik dhe një sërë ndërtimesh, dëshmi e një periudhe të hershme të zhvillimit të qytetit;
  - b) Ansamblin përgjatë rrugës “Naim Frashëri”, i cili dëshmon për proceset e reja që ndodhën gjatë zhvillimit të qytetit në fillimet e shek. XX, siç është formimi i arterieve tregtarë-shoqërore;
  - c) Ansamblin rreth rrugicës së ngushtë tërthor me rrugën “Naim Frashëri” (pjesë e Lagjes së Angjellarëve), përfaqësues tipik i lagjeve të vjetra të qytetit, i cili ruan ende karakterin urbanistiko-arkitekturor fillestare.
3. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten në tabelën më poshtë me koordinata gjeografike, si edhe në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë kësaj rregulloreje.

PËR SHPALLJEN QENDER HISTORIKE TË QYTETIT TË POGRADECIT						
Gjatësi				Gjerësi		
Pika	Gradë	Minuta	Sekonda	Gradë	Minuta	Sekonda
<b>ZONA 1</b>						
Z1	40°	54`	11.83``N	20°	39`	11.31``E
Z2	40°	54`	11.99``N	20°	39`	11.69``E
Z3	40°	54`	11.96``N	20°	39`	12.72``E
Z4	40°	54`	12.25``N	20°	39`	12.70``E
Z5	40°	54`	12.37``N	20°	39`	13.54``E
Z6	40°	54`	12.39``N	20°	39`	14.76``E
Z7	40°	54`	12.68``N	20°	39`	14.64``E
Z8	40°	54`	12.68``N	20°	39`	15.78``E
Z9	40°	54`	13.09``N	20°	39`	16.09``E
Z10	40°	54`	12.84``N	20°	39`	16.66``E
Z11	40°	54`	12.59``N	20°	39`	16.44``E
Z12	40°	54`	12.38``N	20°	39`	17.13``E
Z13	40°	54`	12.57``N	20°	39`	17.40``E
Z14	40°	54`	12.37``N	20°	39`	17.74``E
Z15	40°	54`	14.46``N	20°	39`	19.50``E
Z16	40°	54`	14.08``N	20°	39`	20.39``E

Z17	40°	54`	13.13``N	20°	39`	19.86``E
Z18	40°	54`	12.87``N	20°	39`	20.94``E
Z19	40°	54`	12.03``N	20°	39`	20.15``E
Z20	40°	54`	11.45``N	20°	39`	20.05``E
Z21	40°	54`	11.66``N	20°	39`	19.56``E
Z22	40°	54`	11.15``N	20°	39`	19.02``E
Z23	40°	54`	11.25``N	20°	39`	18.56``E
Z24	40°	54`	10.98``N	20°	39`	18.44``E
Z25	40°	54`	10.91``N	20°	39`	17.45``E
Z26	40°	54`	10.83``N	20°	39`	15.64``E
Z27	40°	54`	11.06``N	20°	39`	15.63``E
Z28	40°	54`	11.18``N	20°	39`	14.47``E
Z29	40°	54`	10.72``N	20°	39`	13.76``E
Z30	40°	54`	10.81``N	20°	39`	13.80``E
Z31	40°	54`	10.59``N	20°	39`	13.42``E
Z32	40°	54`	10.32``N	20°	39`	12.98``E
Z33	40°	54`	11.33``N	20°	39`	11.92``E

### ZONA 2

Z1	40°	54`	11.75``N	20°	38`	59.51``E
Z2	40°	54`	12.03``N	20°	39`	0.41``E
Z3	40°	54`	12.45``N	20°	39`	1.58``E
Z4	40°	54`	11.85``N	20°	39`	2.63``E
Z5	40°	54`	12.53``N	20°	39`	3.18``E
Z6	40°	54`	12.28``N	20°	39`	3.78``E
Z7	40°	54`	12.60``N	20°	39`	4.03``E
Z8	40°	54`	12.36``N	20°	39`	4.60``E
Z9	40°	54`	11.99``N	20°	39`	4.87``E
Z10	40°	54`	12.43``N	20°	39`	5.39``E
Z11	40°	54`	13.95``N	20°	39`	8.52``E
Z12	40°	54`	13.79``N	20°	39`	8.75``E
Z13	40°	54`	13.70``N	20°	39`	8.42``E
Z14	40°	54`	12.43``N	20°	39`	9.68``E
Z15	40°	54`	12.15``N	20°	39`	9.02``E
Z16	40°	54`	12.00``N	20°	39`	9.17``E
Z17	40°	54`	11.70``N	20°	39`	8.59``E
Z18	40°	54`	11.99``N	20°	39`	8.31``E
Z19	40°	54`	11.58``N	20°	39`	7.57``E
Z20	40°	54`	11.37``N	20°	39`	7.97``E
Z21	40°	54`	10.20``N	20°	39`	6.28``E
Z22	40°	54`	10.54``N	20°	39`	5.63``E
Z23	40°	54`	9.85``N	20°	39`	5.12``E

Z24	40°	54`	10.03``N	20°	39`	4.78``E
Z25	40°	54`	8.50``N	20°	39`	3.87``E
Z26	40°	54`	8.57``N	20°	39`	2.82``E
Z27	40°	54`	8.28``N	20°	39`	2.42``E
Z28	40°	54`	8.28``N	20°	39`	1.37``E
Z29	40°	54`	9.01``N	20°	39`	1.48``E
Z30	40°	54`	9.28``N	20°	39`	1.15``E
Z31	40°	54`	9.52``N	20°	39`	1.35``E
Z32	40°	54`	9.70``N	20°	39`	0.78``E
Z33	40°	54`	10.53``N	20°	39`	1.37``E

#### Neni 4 Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko - arkitekturore të Qendrës Historike, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive. Këto ndërhyrje mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.
2. Në Qendrën Historike ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.
3. Për Qendrën Historike kryhen studime për reabilitimin e pjesëve të veçanta të saj lidhur me qëndrimin kundrejt ndërtimeve, të cilat me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozisional të saj.
4. Këto studime përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose të zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.
5. Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozisional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.
6. Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

7. Ndalohen ndërtimet e reja në Qendrën Historike, me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstrukSIONEVE të përmendura në pikat më sipër.

**Neni 5**  
**Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj**

Zona e Mbrojtur shtrihet përreth Qendrës Historike. Ajo mbron vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të reja të qytetit. Zona e Mbrojtur ruhet në përbërësit urbanistikë, arkitekturorë dhe mjedisorë.

Kufijtë e Zonës së Mbrojtur, paraqiten në tabelën e më poshtme me koordinata gjeografike si edhe në hartën e zonifikimit të qytetit të Pogradecit, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

PËR SHPALLJEN E ZONËS TË MBROJTUR TË QYTETIT TË POGRADECIT KORDINATAT GJEOGRAFIKE						
Pika	Gjatësi			Gjerësi		
	Gradë	Minuta	Sekonda	Gradë	Minuta	Sekonda
<b>ZONA 1</b>						
P1	40°	54`	11.82``N	20°	39`	11.33``E
P2	40°	54`	13.27``N	20°	39`	13.84``E
P3	40°	54`	13.54``N	20°	39`	14.01``E
P4	40°	54`	14.41``N	20°	39`	16.02``E
P5	40°	54`	14.26``N	20°	39`	16.28``E
P6	40°	54`	14.30``N	20°	39`	16.25``E
P7	40°	54`	13.45``N	20°	39`	16.23``E
P8	40°	54`	14.13``N	20°	39`	17.34``E
P9	40°	54`	15.20``N	20°	39`	18.15``E
P10	40°	54`	13.43``N	20°	39`	21.44``E
P11	40°	54`	12.03``N	20°	39`	20.15``E
P12	40°	54`	11.45``N	20°	39`	20.05``E
P13	40°	54`	11.06``N	20°	39`	20.56``E
P14	40°	54`	10.57``N	20°	39`	20.15``E
P15	40°	54`	10.20``N	20°	39`	19.73``E
P16	40°	54`	10.48``N	20°	39`	19.21``E
P17	40°	54`	10.60``N	20°	39`	17.97``E
P18	40°	54`	10.47``N	20°	39`	18.02``E
P19	40°	54`	10.54``N	20°	39`	17.65``E
P20	40°	54`	10.15``N	20°	39`	17.59``E
P21	40°	54`	9.75``N	20°	39`	17.21``E
P22	40°	54`	10.16``N	20°	39`	16.62``E

P23	40°	54`	9.51``N	20°	39`	15.79``E
P24	40°	54`	9.41``N	20°	39`	15.31``E
P25	40°	54`	10.09``N	20°	39`	14.66``E
P26	40°	54`	10.42``N	20°	39`	14.01``E
P27	40°	54`	10.81``N	20°	39`	13.80``E
P28	40°	54`	10.59``N	20°	39`	13.42``E
P29	40°	54`	10.32``N	20°	39`	12.98``E
P30	40°	54`	11.33``N	20°	39`	11.92``E

### ZONA 2

P1	40°	54`	11.48``N	20°	38`	58.42``E
P2	40°	54`	12.03``N	20°	39`	0.41``E
P3	40°	54`	13.14``N	20°	39`	3.21``E
P4	40°	54`	12.89``N	20°	39`	3.68``E
P5	40°	54`	13.84``N	20°	39`	6.15``E
P6	40°	54`	13.64``N	20°	39`	6.51``E
P7	40°	54`	13.30``N	20°	39`	6.75``E
P8	40°	54`	13.46``N	20°	39`	7.12``E
P9	40°	54`	12.49``N	20°	39`	7.60``E
P10	40°	54`	10.23``N	20°	39`	4.40``E
P11	40°	54`	10.17``N	20°	39`	4.65``E
P12	40°	54`	9.51``N	20°	39`	3.82``E
P13	40°	54`	9.30``N	20°	39`	3.98``E
P14	40°	54`	8.76``N	20°	39`	3.02``E
P15	40°	54`	7.89``N	20°	39`	2.30``E
P16	40°	54`	8.20``N	20°	39`	1.90``E
P17	40°	54`	8.12``N	20°	39`	1.36``E
P18	40°	54`	7.98``N	20°	39`	1.24``E
P19	40°	54`	7.54``N	20°	39`	0.23``E
P20	40°	54`	10.13``N	20°	39`	59.77``E
P21	40°	54`	8.85``N	20°	39`	59.04``E
P22	40°	54`	10.13``N	20°	39`	58.81``E

### Neni 6 Ndërhyrjet në Zonën e Mbrojtur

1. Në Zonën e Mbrojtur ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe për përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.
2. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përvèç rikonstruksionit të tij. Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet t'i kalojë 3 katet dhe jo më tepër se 10 m deri në kornizën e çatisë.
4. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfollogjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.
5. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas, procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

**Neni 7**  
**Ndarja e monumenteve sipas kategorive**

1. Monumentet e kulturës në qytetin e Pogradecit, sipas vlerave të tyre historiko - kulturore ndahen në dy kategorier:
  - a) monumente të kategorisë së parë;
  - b) monumente të kategorisë së dytë.
2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur ose në pjesët e tjera të qytetit. Kjo ndarje sipas vlerave, pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese e restauruese.

**Neni 8**  
**Monumentet e kategorisë së parë**

1. Monumentet e kategorisë së parë janë ndërtime me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale korçare.
2. Monumentet e kategorisë së parë, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrëthuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tillë, i nënshtrohen të njëjtit trajtim.
3. Monumentet e kategorisë së parë ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur dhe në pjesën tjeter të qytetit.
4. Në monumentet e kategorisë së parë kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike dhe funksionale, nuk mund të ndryshohen, me përashtim të vendosjes së nyjës higjieno-sanitare, kur është e domosdoshme dhe kur nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

5. Deri në shpalljen e Zonës së Mbrojtur të monumenteve të kategorisë së parë, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, për aq sa nuk bie në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës.
6. Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR) rast pas rasti.

**Neni 9**  
**Monumentet e kategorisë së dytë**

1. Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por edhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.
2. Monumentet e kategorisë së dytë ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.
3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë së dytë lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimi i teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme.

**Neni 10**  
**Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike dhe në monumente të vecanta**

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës (IMK) dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).
2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet prej Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë (DRKK) ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervizorit dhe kolaudatorit, caktuar prej IMK-së. Për monumentet e kulturës pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhen në përputhje me legjisacionin në fuqi.
3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në pikat 3, 4, 5 dhe 6, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë (DRKK), ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

- Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit ose nga persona të licencuar në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

### **Neni 11 Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur**

- Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas rregullores së miratuar. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
- Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme përfshinë e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
- Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet prej subjekteve ndërtimore që janë të licencuar përfshinë këtë kategori.
- Projektet përfshinë ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim përfshinë e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.
- Projektet e rikonstruksionit të rrugëve, shesheve dhe infrastrukturës së tyre, të përmendura në nenin 6, hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim përfshinë kategorinë përkatëse të fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

### **Neni 12 Shfrytëzimi i monumenteve**

Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës urbane të qytetit. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, përfshinë përfshinë përfshinë cilat janë ndërtuar apo dhe përfshinë funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat përfshinë cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës përfshinë funksione të ndryshme nga ato përfshinë cilat janë ngritur bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin

nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

**Neni 13**  
**Mbrojtja e monumenteve**

Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridikzionit të tyre. Plani rregullues i qytetit të Pogradecit, detyrimisht, merr parasysh vlerat e Qendrës Historike.

**Neni 14**  
**Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike**

Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e Qendrës Historike dhe monumenteve të kulturës në qytetin e Pogradecit, pranë bashkisë së qytetit ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jo vendimmarrëse, i cili përbëhet nga 7 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të qytetit dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të përfaqësuesve të banorëve të Qendrës Historike dhe organizmave joshtetërorë që ushtrojnë veprimitari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të qytetit të Pogradecit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm, që miratohet me 50%+1 të votave të të gjithë anëtarëve.

**Neni 15**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe, për pasojë, nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

**Neni 16**  
**Kundërvajtjet administrative**

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi kundërvajtësit, sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 17**  
**Dispozita të fundit**

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet harta e zonifikimit të Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur të qytetit të Pogradecit.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, i paraqet ministrit përgjegjës listën e monumenteve të kulturës të kategorisë së parë e të dytë për shqyrtim dhe miratim.

NR.PROT.2280/3  
DATË 18.6.2015

MINISTRISË SË KULTURËS  
MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME  
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET  
ME PARLAMENTIN  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGACI**

